

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje me gjyqtarin Agim Maliqi kryetar i trupit gjykues dhe me gjyqtarët profesionistë Ibrahim Idrizi dhe Sahit Krasniqi, anëtar, si dhe me sekretaren juridike Albana Ajvazi, në lëndën penale kundër të akuzuarit R. S, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes e parashikuar dhe e ndëshkuar me nenin 256 par. 2 lidhur me nen. 23 të KPK-së, të akuzuarit A. Xh për shkak të veprës penale në bashkëkryerje rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes e parashikuar dhe e ndëshkuar me nenin 256 par. 2 lidhur me nen. 23 të KPK-së si dhe për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par. 1 nënpar. 10 lidhur me nenin 20 të KPK-së, si dhe kundër të akuzuarit Z. B për veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale, rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo grabitjes e parashikuar dhe e ndëshkuar me nenin 256 par. 2 lidhur me nenin 25 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë, PP nr.783-7/05 të datës 13.05.2013, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Rasim Maloku, të akuzuarit R. S dhe mbrojtësi i tij me autorizim av. N.Sh, të akuzuarit A. Xh dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. B. T, të akuzuarit Z. B dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare av. O. H, përfaqësuesi i të ndjerit B. B, N. B dhe të dëmtuarit S. M, pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me datat 14/15 mars, 2/3 dhe 29 prill, 13 maj 2013, më 15 maj 2013 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

R. S, nga i ati dhe e ëma e gjinisë, i lindur mënë, rr. “.....” pn, ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shtatë vjet të shkollës fillore, i gjendjes së dobët ekonomike.

A. XH, me nofkën “.....”, nga i ati dhe e ëma e gjinisë, i lindur më Komuna e Sarajit, Republika e Maqedonisë, shqiptar, shtetas i Maqedonisë, i martuar baba i gjashtë fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike.

Z. B, me nofkën “.....”, nga i ati dhe e ëma e gjinisë i lindur më në Komuna e Kaçanikut, tani me banim në Ferizaj,, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të kryer katër vite të shkollës fillore, i gjendjes së dobët ekonomike.

Në bazë të nenit 390 par. 1 nënpar. 3 të KPPK-së.

LIROHEN NGA AKUZA

R. S dhe A. Xh

1. Me datën 01 dhjetor 2005, rreth orës 16:10 në lokalit “.....”, që gjendet në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Ferizaj, me qëllim që vetes ti sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, me përdorimin e forcës – revoles kanë përvetësuar një sasi ari, në atë mënyrë që pas marrëveshjes paraprake dhe qëndrimit një ditë në Ferizaj në banesën e të akuzuarit të tretë, kanë përgatitur kryerjen e veprës penale, kështu që ditën kritike të pandehurit kanë hyrë brenda në lokalit ku i ndjeri B. B punonte si tregtar me pakicë i arit, me ç’rast i pandehuri i dytë me kanosje me revole të markës së panjohur e ka kërcënuar të ndjerin me fjalët “Shtriju-Shtriju”, i cili nga kanosja është shtrirë në dysheme, e pastaj i akuzuari i parë ka filluar të mbledhë arin në sirtar rreth banakut, kurse i akuzuari i dytë ka qëndruar brenda afër derës dhe në momentin kur ka tentuar të hyjë brenda i dëmtuari S.M – polic i Kosovës, që ishte njoftuar nga një vajzë për rastin e dyshimt, në befasi është qëlluar nga i akuzuari i dytë në pjesën e kokës, me një plumb të shkrepur nga revolja, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore në disa pjesë të kokës nga copëtimi i predhës për shkak të vendosjes së shurdhuesit në tytën e revoles, kështu që humbë vetëdijen dhe rrëzohet brenda në lokal, atëherë i pandehuri i dytë shkrep edhe tre plumba dhe tre plumba në trupin e tani të ndjerit B. B duke i shkaktuar gjathtë plagë nga efekti i copëtimit të predhave, nga të cilat plaga në kokë dhe në abdomen kanë qenë vdekjeprurëse, e pastaj me arin e vjedhur e fshehin te një person tani i panjohur, kurse pas disa minutave largohen me një taksì për në Han të Elezit, ku edhe arrestohen nga policia.

- **me që nuk është provuar që në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes e parashikuar dhe e ndëshkuar me nenin 256 par. 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së.**

A. Xh

2. me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në pikën një të dispozitivit të aktakuzës, me dashje direkte ka tentuar të privoj nga jeta policin e Kosovës S.M, i cili ishte në detyrë zyrtare në sigurimin e objektit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, me qëllim që të pamundësoj zbulimin e veprës penale të grabitjes, në atë mënyrë që në momentin kur i dëmtuari S.M pasi ishte njoftuar nga dëshmitarja – R. S se brenda në lokalit e të ndjerit B. B po ndodh diçka jo e zakonshme, ka tentuar të hap derën e lokalit Berisha, mirëpo menjëherë është qëlluar në pjesën e kokës me një plumb nga i pandehuri, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore në disa pjesë të kokës nga copëtimi i predhës nga efekti i mjetit shurdhues që ishte vendosur në tytën e revoles, nga e cila goditje humbë vetëdijen dhe rrëzohet brenda në lokal, e pastaj bashkë me të pandehurin e parë janë larguar nga lokali me arin e vjedhur.

- **me që nuk është provuar se ka kryer veprën penale vrasja e rëndë në tentativë e nga neni 147 par. 1 nënpar. 10 lidhur me nenin 20 të KPK-së.**

Z. B

3. Me datën 30 nëntor dhe 1 dhjetor 2005 në lokalit e tij – qebaptoren në rr. “Vëllezërit Gërvalla” dhe banesën në rr. në Ferizaj, me dashje ju ndihmoj të pandehurve R. S dhe A. Xh në kryerjen e veprës penale të grabitjes siç përshkruhen në pikën 1 të dispozitivit të kësaj

aktakuze, në atë mënyrë që i ka strehuar në banesë me datën 30 nëntor, ju ka dhënë ushqim dhe pije në qebaptoren e tij dhe i ka udhëzuar për mënyrën e kryerjes së veprës duke iu treguar lokalitë e të ndjerit B..., të cilin e ka njohur edhe më herët me që kanë prejardhjen fshati i njëjti Dubravë, Komuna e Kaçanikut dhe janë të afërm, si dhe duke ju premtuar fshehjen e sendeve të përfituara nga vepra penale, me çka ju ka mundësuar kryerjen më të lehtë dhe largimin nga vendi i kryerjes për në Han të Elezit.

- **meqë nuk është provuar që ka kryer veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo grabitjes nga neni 256 par. 2 lidhur me nenin 25 të KPK-së.**

Përfaqësuesi i të ndjerit B. B, bashkëshortja e tij N. B, dhe i dëmtuari S.M, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen në kontest civil.

Shpenzimet bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m i

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën PP nr. 783-7/05 të datës 2.8.2006, ndaj të akuzuarve R. S, A. Xh dhe Z. B, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje rastet të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes nga neni 256 par. 2 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, për shkak të veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 147 par. 1 pika 10 lidhur me pikën 11, lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPPK-së, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, në të akuzuarit R. S për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par. 3 lidhur me par. 1 të KPPK-së, si dhe ndaj të akuzuarit A. Xh për veprën penale kalimi i pa autorizuar i vendkalimeve kufitare, ose i vijës kufitare nga nenin 114 par. 2 lidhur me par. 1 të KPK-së.

Me aktvendimi e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, KA.nr. 593/2006 të datës 29.08.2006, është konfirmuar aktakuza ndaj të akuzuarve R. S dhe A. Xh, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje rastet të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes nga neni 256 par. 2 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, për shkak të veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 147 par. 1 pika 10 lidhur me pikën 11, lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPPK-së, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, në të akuzuarit R. S për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par. 3 lidhur me par. 1 të KPPK-së, si dhe ndaj të akuzuarit A. Xh për veprën penale kalimi i pa autorizuar i vendkalimeve kufitare, ose i vijës kufitare nga nenin 114 par. 2 lidhur me par. 1 të KPK-së.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktgjykimin e saj P. Nr. 610/2006 të datës 29.11.2007, shpalli fajtor të akuzuarin A. Xh duke i shqiptuar dënim burgimi afatgjatë në kohëzgjatje prej 30 vitesh, të akuzuarit R. S dënim burgimi afatgjatë në kohëzgjatje prej 22 viteve, kurse të akuzuarit Z. B dënim burgimi në kohëzgjatje prej 10 viteve, kurse ka liruar nga akuza R. S dhe Z. B, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim, ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve, nga neni 328 par. 2 të KPPK-së, kurse Z. B e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale, vrasja e rëndë në tentativë nga neni 147 par. 1 pika 10, lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin e saj të dt. 16.12.2008, ka aprovuar ankesat e mbrojtësit të të akuzuarve ashtu që ka anuluar këtë aktgjykim dhe çështjen e ka kthyer për rigjykim.

Kurse Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktgjykimin e saj P. Nr. 40/2009 të datës 09.06.2011, shpalli fajtor të akuzuarin A. Xh duke i shqiptuar dënim burgimi afatgjatë në kohëzgjatje prej 30 viteve, të akuzuarit R. Sa dënim burgimi afatgjatë në kohëzgjatje prej 22 viteve, kurse të akuzuarit Z. B dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 viteve, kurse ka refuzuar ndaj R. S, për shkak të veprës penale, vrasja e rëndë në tentativë nga neni 147 par. 1 pika 10, lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së, si dhe ndaj të akuzuarit A. Xh për shkak të veprës penale kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 114 par. 2 lidhur me par. 1 të KPK-së.

Lidhur me këtë Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin e dt. 12.01.2012, ka refuzuar akuzën ndaj të akuzuarit R. S për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit publik nga neni 332 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK-së. kurse në pjesën e dytë ka miratuar ankesat e mbrojtësve ashtu që ka anuluar aktgjykimin dhe çështjen e ka rikthyer në rivendosje.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka filluar shqyrtimit gjyqësor me dt. 17.09.2012 sipas akuzës së ndryshuar¹, me ç'rast shqyrtimi gjyqësor është ndërprerë e që për shkak të riorganizimit të sistemit gjyqësor në Kosovë, kjo lëndë ka kaluar në kompetencë të Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Gjykata Themelore në Ferizaj duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 14/15 mars, 02/03/29 prill si dhe 13/15 maj 2013, kurse Prokurori i Shtetit Rasim Maloku, në fazën e ndryshimit të akuzës, ndryshoj akuzën,² siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi, duke i propozuar Gjykatës, që të akuzuarit R. S, A. Xh dhe Z. B, të shpallen fajtor dhe tu shqiptohen dënimet e parapara me ligj për këto vepra penale.

2. Mbrojtja e të akuzuarve R. S, A. Xh dhe Z. B

I akuzuari R. S, në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo grabitjes nga neni 256 par. 2 të KPK-së, kurse mbrojtjen e tij nuk e ka paraqitur fare në këtë shqyrtim gjyqësor përveç se në fjalën përfundimtare duke kërkuar nga Gjykata që ta liroj nga akuza për këtë vepër penale, për të tepër ka kërkuar drejtësi se nuk i kam borxh askujt dhe nuk e ka vuarë askënd. Përndryshe i akuzuari nuk ka kontestuar faktin se një natë më herët i kishte ndihmuar të akuzuarit A.. që të kalonte kufirin e Maqedonisë dhe së basku metë ishin ardhur dhe kishin kaluar një natë në banesën e të akuzuarit Z. B, kurse të nesërmen kanë dashur të kthehen në shtëpitë e tyre, po ashtu ka pohuar se janë ndaluar nga policia e pastaj janë lëshuar kurse janë arrestuar në orët e mbrëmjes në Han të Elezit.

¹ Shih ndryshimin e akuzës në formë të shkruar të datës 17.09.2012

² Shih ndryshimin e akuzës dhe fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit në formë të shkruar.

I akuzuari A. Xh, po ashtu në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale, rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo grabitjes nga neni 256 par 2 të KPK-së, e as për veprën penale vrasja e rëndë në tentativë par. 1 nënpar. 9 të KPK-së, e po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor është mbrojtur në heshtje, kurse në fjalën përfundimtare ka kërkuar që ta liroj nga akuza për këto vepra penale. I njëjti gjatë shqyrtimeve tjera gjyqësore, e po ashtu edhe gjatë procedurës hetimore, nuk e ka kontestuar asnjëherë faktin se një natë para se të arrestohej nga ana e policisë ka ardhur në Ferizaj dhe ka qëndruar një natë në banesën e të akuzuarit të tretë Z. B, të cilin e ka njohur 25-30 vite më parë, po ashtu ka pohuar faktin se kufirin Maqedoni-Kosovë e ka kaluar ilegalisht me që nuk ka poseduar pasaportë, nga fakti se ka qenë i angazhuar në konfliktin në Maqedoni. Ka mohuar në mënyrë kategorike se ka marrë pjesë në rastin në fjalë për më tepër për rastin ka dëgjuar me rastin e ndalimit nga patrulla policore, e duke shtuar faktin se nuk ka pasur as kaqketë, as kapuç dhe as armë me vete atë ditë.

Po ashtu edhe i akuzuari Z. B, në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo grabitjes nga neni 256 par. 2 të KPK-së, i cili po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor është mbrojtur në heshtje, kurse në fjalën përfundimtare ka kërkuar lirim të tij nga akuza. Po ashtu edhe ky i akuzuar nuk ka mohuar faktin se me dt. 31.11.2005, në cilësinë e mysafirëve në banesën e tij kanë qëndruar një natë R... dhe A... e të cilët diku rreth orës 17:00, kanë dalur nga qebaptorja e tij në rr. “.....” dhe kanë vazhduar për në shtëpitë e tyre. Po ashtu edhe ky i akuzuar më tutje në rrëfimin e tij ka shtuar se që një kohë të gjatë e ka njohur A. Xh, kurse nuk e ka njohur të ndjerin B. B, porse ka dëgjuar se është djali i M..., B..., nga fsh. Dubravë dhe këtë e ka mësuar natën kur është arrestuar nga ana e policisë.

3. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që të akuzuarit R. S, A. Xh dhe Z. B, nuk kanë pranuar fajësinë për asnjë pikë të dispozitivit të kësaj akuze, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarve gjatë shqyrtimeve të mëparshme gjyqësor dhe gjatë procedurës hetimore;

- nga dëgjimi i dëshmitarëve – përfaqësuesi i të ndjerit B. B, bashkëshortja N. B, i dëmtuari S.M, dëshmitarët e tjerë B.I, M. J, N.H, E.I, N.S, R.S, M.R, B.Xh dhe Sh. S,³ gjenden jashtë shtetit, dëshmitë e tyre konform nenit 368 par. 1 nënpar. 1 të KPPK-së, janë lexuar me propozimin e prokurorit të shtetit dhe pajtimin e të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, ngase paraqitja e tyre në gjykatë ka qenë e pamundur.

- nga leximi dhe shikimi në formës së ruajtjes së sendeve dhe nga leximi dhe shikimi në raportin e autopsisë për të ndjerin B. B i dt. 9.12.2005;

- nga leximi dhe shikimi i raportit të krim teknikës 1.12.2005;

³ Shih raportet policore, ku zyrtarisht është konfirmuar se të njëjtit gjenden jashtë shtetit.

- nga leximi dhe shikimi në skicën në vendin e ngjarjes;
- nga leximi dhe shikimi në foto dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës;
- nga leximi dhe shikimi opinioni i ekspertit për analizën e ADN-së të dt 22.05.2006, dhënë nga Prof.Dr. M. S;
- nga leximi dhe shikimi në procesverbalin mbi identifikimin e personave 12.05.2006;
- nga leximi dhe shikimi në raportin e ekspertizës i prezantuar në raportin e policisë kriminale në Turqi i dt. 29.11.2007;
- Nga leximi dhe shikimi mendimin dhe konstatimi i e dr. T. G në seancën e dt. 30.9.2007 dhe 8.10.2007;
- nga leximi dhe shikimi në konstatimin dhe mendimi i ekspertit të balistikës prof. H. K të dt. 30.9.2007;
- nga leximi dhe shikimi në njoftimin nga zyra e Interpolit në Shkup i përcjell nga ana e ministrisë së drejtësisë së Kosovës nr. 1660 të dt. 23.04.2010;
- nga raporti i detyrës për ndërrimin “D” i dt. 01.12.2005 prej orës 8:00 deri në 24:00;

4.Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht Gjykata vlerëson si të vërtetuara dhe të pakontestueshme faktet si në vijim:

- me date 1 dhjetor 2005 në Ferizaj, në rr. “Dëshmorët e Kombit” rreth orës 16:10 ndodhi një grabitje e armatosur;
- grabitja ndodhi ne argjendarinë “Berisha” në Ferizaj ku u vra argjendari B. B;
- me qëllim të parandalimit të krimit si pasoje e ndërhyrjes ne kryerjen e detyrave te tij zyrtare mbeti i plagosur pjesëtari i Policisë se Kosovës përkatësisht i dëmtuari S.M;
- të dy edhe i ndjeri edhe i dëmtuari u qëlluan me një revole te kalibrit 7.65 mm, me silenciator (shurdhues);
- këtë grabitje u vodh një sasi e arit e papërcaktuar, e cila nuk u gjend as sot e kësaj dite;
- ne këtë grabitje morën pjese së paku dy persona qe kryen këto vepra penale.

Faktet që u potencuan më lartë, paraqesin komponentën objektive të veprës penale, andaj Gjykata në këtë shqyrtim gjyqësor është përqendruar në vërtetimin e komponentës subjektive të veprës penale nga shkaku se enigmatike ka qenë pikërisht kjo komponentë e cila edhe sipas instruksioneve të Gjykatës Supreme të Kosovës e shprehur përmes vendimeve të saj nuk është ndriçuar në mënyrë bindëse dhe të pakontestueshme në shqyrtimet e mëparshme gjyqësore, andaj rrjedhimisht pjesa më e madhe e shqyrtimit gjyqësor e natyrshëm edhe e arsyetimit të këtij aktgjykimi do të jetë e përqendruar pikërisht në trajtimin e këtij aspekti.

Nga përmbajtja e dëshmisë së përfaqësueses së të ndjerit B. B, dëshmitares N. B, kjo dëshmi nuk ka të bëjë me sqarimin e rastit në ditën kritike (meqë nuk ka qenë dëshmitar okular i ngjarjes), por dëshmia e saj është e vlefshme përkitazi me sqarimin e raporteve

afariste që paraprakisht ka pasur i ndjeri, për më tepër përmes dëshmisë së saj (në të gjitha fazat e procedurës penale) ka paraqitur fakte se nuk ka pasur njohuri se i ndjeri të ketë pasur ndonjë mosmarrëveshje e mbi të gjitha nuk ka mundur që të jap ndonjë fakt përkitazi me biznesin e zhvilluar nga ana e të ndjerit. Më tutje në dëshminë e saj ka shtuar se nga viti 2003 kanë jetuar në Ferizaj kurse bashkëshorti i saj ka punuar si argjendar në argjendarin “Berisha”, i cili lokal ka qenë përballë gjykatës së Ferizajt. Në këtë argjendari kryesish ka punuar vetëm bashkëshorti i saj, kurse gjatë kohës sa ka qenë e martuar nuk ka dëgjuar nga i njëjti që ti ketë pasur borxh dikujt apo ndokush ti ketë pasur borxh të ndjerit. Kurse sa i përket furnizimeve që ka bërë bashkëshorti i saj rreth argjendarisë nuk ka mundur të japi ndonjë informacion më të hollësishëm se nga kush është furnizuar me ari, e po ashtu ka shtuar se ditën kur ka ndodhur ngjarja në argjendari ka pasur rreth 15 kg ari kurse i është kthyer nga policia sasia prej 9 kg.

Më tutje në rrëfimin e saj ka deklaruar se i ndjeri ka jetuar në Shkup, por prejardhjen e ka pasur nga fsh. Dubravë komuna e Kaçanikut, ai atje ka lindur dhe nuk ka jetuar gjatë në atë fshat dhe sipas njohurive që ajo ka as që ka qenë ndonjëherë atje.

Kurse sa i përket ditës kritike ka pohuar se ka dëgjuar nga persona të panjohur se pak para se të ndodhte rasti, se personi me emrin B... diku rreth mesditës ka drekuar së bashku me të ndjerin, e po ashtu nga persona të pa njohur ka dëgjuar se personat që kanë kryer vrasjen janë nga Shkupi dhe njëri në mesin e tyre ishte i veti, duke aluduar në Z. B, meqë babi i Z.. dhe babi i të ndjerit janë nga i njëjti fshat.

Në cilësinë e përfaqësueses së të ndjerit B. B, i është bashkëngjitur ndjekjes penale dhe ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike të cilën nuk ka mundur ta precizoj në shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar dëshminë e kësaj dëshmitareje përkundër gjendjes së saj të kuptueshme emocionale si pasojë e humbjes së bashkëshortit, megjithatë dëshmia e saj ishte e saktë dhe objektive duke u përqendruar në raportet afariste të të ndjerit, kurse sa i përket pjesës së deklarimit të saj, përkitazi me kryesit e veprës penale, ajo shprehet “...Është e vërtet se gjatë procedurës hetimore në prokurori kam deklaruar se unë nuk dyshoj në askënd, por tani pasi janë mbajtur disa shqyrtime gjyqësore unë edhe kam marrë pjesë në to dhe kam dëgjuar deklaratimet e dëshmitarëve tani dyshoj se pikërisht këta janë personat që kanë kryer këtë vepër penale por diçka konkrete në lidhje me këtë nuk kam.”⁴ që tregon se e njëjta megjithatë është influencuar nga shqyrtimet gjyqësore të mbajtura më herët dhe atë nga fakti se nuk ka arritur të ofroj ndonjë provë konkrete lidhur me pretendimet e saj të cituara më lartë.

Nga deklarata e të dëmtuarit/dëshmitarit S.M, i cili njëherit është dëshmitari kryesor i kësaj ngjarje, pasi që i njëjti ishte plagosur nga personat, të cilët kishin kryer grabitjen në argjendari, kurse nga përmbajtja e dëshmisë së tij vërtetohet se ditën kritike rreth orës 16:00, më nipin e tij kishin pirë kafe në kafiterin “.....” dhe pasi kishte dal, në rrugicë një vajzë e ka njoftuar se është një problem në argjendari, i cili menjëherë ka shkuar deri tek dera e argjendarisë, aty ka parë dy persona brenda njëri ishte pas dera dhe tjetri ishte përpara vendit ku gjendet ari – tavolina e shërbimit, dera ishte e hapur 20 -30 cm. deri sa e ka kapur rezën e derës, më tutje nuk i kujtohet asgjë pasi i ka humbur vetëdija, e pasi që i është kthyer vetëdija, ka përshkruar momentin kur është ndihmuar nga dy persona tjerë të cilët e kanë dërguar në spital.

⁴ Shih faqen 17 të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor

Më tutje dëshmitari në dëshminë e tij është përqendruar në identifikimin e kryerësve të kësaj veprë penale duke potencuar faktin se në argjendari ka parë dy persona një person ishte prapa derës në argjendari dhe ishte më i shkurtër dhe më i pa rruar dhe tjetri ishte pak më i gjatë dhe ishte më pak i rruar, duke vazhduar ngjarjen me disa persona të panjohur që deri sa ka qenë duke pirë kafe i ka parë në kafiterinë “.....” ashtu që i ka përshkruar që kanë pasur kapela në kokë kurse veshja e tyre ka qenë me jakne të zezë e bluza ngjyrë kafe, të cilët kanë dalë nga kafiteria më herët por nuk ka mundur të deklarohet për ngjashmërinë e personave në kafiteri dhe personat që ka parë në argjendari, pasi ka qenë për një interval shumë të shkurtër kohorë për dy apo tre sekonda, e po ashtu nuk ka mundur të përshkruaj tiparet e fytyrave të këtyre personave. Sa i përket lëndimit të tij trupor, dëshmitari përshkruan lëndimet që i ka marrë në pjesën e qafës-kokës dhe në këmbën e djathtë, e që nuk mund ta dijë se si ka ndodhur, por për disa momente ka humbur vetëdijen, pa mundur në mënyrë të çartë të sqaroj se është sulmuar nga personi brenda argjendarisë apo nga ndonjë person tjetër jashtë argjendarisë.

Më tutje dëshmitari në rrëfimin e tij ka shtuar se pas kthimit të vetëdijes i kujtohet se ka qenë brenda në argjendari, ka nxjerrë revolen e tij dhe ka tentuar që të dali zhagas nga aty e që i kanë ndihmuar dy persona të tjerë-kalimtarë të rastit, e që më vonë është kuptuar se këta dy persona, të cilët i ndihmuar janë dëshmitarët E. I dhe SH. S.

Dëshmitari më tutje ka vazhduar se pas dy apo më shumë ditë është vizituar nga polici M. J dhe policia N. H me të cilët ka zhvilluar një bisedë, e pas kësaj ka shikuar edhe 5-6 fotografi nga të cilat ka identifikuar përafërsisht dy prej tyre, të cilët kanë përngjarë në personat që i ka parë në argjendari. E që identifikimin e përafërt të tyre e ka bërë vetëm në bazë të mjekrës dhe kapelës, për më tepër ky dëshmitarë edhe në deklaratimet e tij të mëparshme ka theksuar faktin se nuk është i sigurt në identifikimin e këtyre dy personave dhe siguria e tij është 60%-70%, e të cilit deklaram i është përmbajtur në të gjitha fazat e procedurës penale.

Kurse gjatë fjalës përfundimtare ka kërkuar dënimin e të akuzuarve, si dhe ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike pa mundur ta precizoj lartësinë e saj.

Gjykata dëshminë e këtij dëshmitari e ka vlerësuar si dëshmi objektive, të besueshme e që bëhet fjalë për një dëshmitarë me një ndershmëri të lartë, i cili natyrshëm ka përshkruar ngjarjen por, megjithatë dëshmia e tij vihet në pikëpyetje të madhe sa i përket saktësisë dhe sigurisë së saj përkatësisht identifikimit të personave që kryen veprën penale në fjalë, për më tepër duke pasur parasysh faktin se bëhet fjalë për dëshmitarin kyq i cili ngjarjen e ka parë nga afërsia, dëshmia e tij duhet vlerësuar në mënyrë të gjithanshme dhe shumëdimensionale e posaçërisht në mënyrë kronologjike prej dëshmisë së tij fillestare e deri në shqyrtimin e fundit gjyqësor, e assesi nuk mundet që kjo dëshmi të vlerësohet në mënyrë fragmentare, andaj mbi këtë bazë duhet analizuar në mënyrë të hollësishme faktorët si në vijim:

- së pari në asnjë fazë të procedurës penale që nga deklarimi i tij i parë, nuk ka qenë i sigurt se është sulmuar nga personi brenda apo ndonjë person jashtë argjendarisë, apo edhe duke mos mundur të jap këto detaje në mënyrë të sigurt përkatësisht duke paraqitur versione të ndryshme dhe atë “...unë mendoj se kam qenë i sulmuar nga prapa jashtë para derës së argjendarisë nga persona të tjerë...”,⁵ për të vazhduar “...kur jam ofruar tek dera e

⁵ Procesverbali mbi intervistimin e të dëmtuarit – viktimës i dt. 27.12.2005

argjendarisë më duket se mu ka paraqitur dikush si zi afërsisht gjysmë minute apo një minute sa ka zgjatë kjo, pasi më ka ardh vetëdija kam parë veten në argjendari...”,⁶ kurse në shqyrtimin e parë gjyqësor ka dëshmuar se “shumë shpejt është sulmuar dhe goditë me plumba në kokë në pjesën e pasme dhe në pjesën e parë, përkatësisht në gojë dhe fytyrë”,⁷ sikurse shprehet edhe në shqyrtimin e dytë gjyqësor “Unë jam i bindur se asnjëri nga këta persona nuk më ka plagosë, por jam i bindur se mua më ka plagosë një person i tretë i cili ka qenë jashtë lokalit dhe më ka goditë nga prapa”;⁸

- po ashtu nuk ka mundur asnjëherë në mënyrë të sigurt të bëjë përshkrimin e autorëve të veprës penale, nga fakti se asnjëherë, nuk ka mundur që të përshkruaj në mënyrë të hollësishme dhe të detajuar ndonjë nga tiparet e personave, ashtu që pothuajse gjithnjë ka përshkruar vetëm gjatësinë dhe pamjen e mjekrës së tyre, “...se kanë qenë të parruar dhe atë njëri person ka pas një mjekër komplet, kurse tjetri mjekër më të vogël, kurse në asnjë rrethanë nuk ka mundur të jap ndonjë përshkrim të tipares së fytyrës së tyre”⁹;

- nuk është i saktë përkitazi me moshën e të akuzuarve ashtu që pohon se se janë të moshës 25 deri në 30 vjeçare e që është në disharmoni me moshën e të akuzuarit A. Xh i cili në kohën e ndodhjes së veprës penale ishte dukshëm më i shtyrë në moshë (mbi 40 vjeçar);

- përshkruan vetëm veshjet e personave të veshur me jakne të zeza dhe këmbë ngjyrë kafe me kapela në kokë herë të vunicës e herë të bejzbollit e herë kasketa e që është e qartë se nuk janë gjetur askund as kapela e as veshje të këtij lloji tek të akuzuarit;

- përfundimisht asnjëherë dëshmitari nuk ka qenë në gjendje që në mënyrë të sigurt të identifikojë këta persona, por gjithmonë ka dëshmuar se të akuzuarit përngjajnë në personat të cilët i ka parë në argjendari, e për më tepër siguria e tij ka qenë fillimisht 60% për të vazhduar në 70% dhe asnjëherë nuk e tejkalon këtë përqindje.

Megjithatë Gjykata vlerëson se është plotësisht e natyrshme dhe e kuptueshme pasaktësia dhe pasiguria e dëshmisë së tij duke marrë parasysh një mori faktorësh dhe atë rrethanat, kohën, dramaticitetin dhe shpejtësinë e zhvillimit të ngjarjes në ditën kritike, e posaçërisht:

- pamja e dëshmitarit për një kohe shumë të shkurtër “...personat që i kam parë në argjendari i kam parë për intervalin e shkurtër kohor 2 apo 3 sekonda.”¹⁰

- në një kohë para muzgut (fakt i vërtetuar nga shumica e dëshmitarëve) ;

- tërësisht i papërgatitur dhe i papërqendruar për një ngjarje të përmasave të tilla siç edhe vet pohon “...e kam kuptuar si mosmarrëveshje rreth kthimit të mallit pasi që shpesh herë kemi pasur raste të tilla dhe për këtë edhe nuk e kam përgatitur armën paraprakisht...”¹¹

Andaj të gjitha rrethanat e sipër cekura vënë në pikëpyetje të madhe tek trupi gjykues se në të vërtetë a arriti ti identifikonte qartë dhe sigurt se pikërisht të akuzuarit ishin personat

⁶ Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dt. 28.12.2005

⁷ Procesverbali i shqyrtimit të parë gjyqësorë dt. 6.11.2006 faqe 3

⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësorë dt. 02.04.2007.

⁹ Procesverbali i shqyrtimit të fundit gjyqësor dt. 14.3.2013 faqe 5, dëshmia e dëshmitarit S.M.

¹⁰ Po aty

¹¹ Procesverbali i shqyrtimit të fundit gjyqësor dt. 14.3.2013 fq. 6

që kryen këtë vepër penale, e që mbi këtë bazë padyshim se duhet vlerësuar të gjithë këta faktorë. Natyrshëm se tek dëshmia e dëshmitarit duhet analizuar perceptimin e tij për ngjarjen, ndershmërinë dhe posaçërisht saktësinë dhe sigurinë e tij e që në këtë rast trupi gjykues nuk ka vënë në dyshim ndershmërinë e tij por saktësinë dhe sigurinë. Andaj natyrshëm se nga faktorët e lartëcekur është e qartë se dëshmitari nuk arriti as përafërsisht në mënyrë të sigurt dhe të saktë të identifikoj kryerësit e kësaj veprë penale, kurse për identifikim të plotë as që ia vlen të trajtohet më tutje.

Po ashtu edhe dëshmia e dëshmitarit B. I, paraqet dëshminë më të rëndësishme në këtë proces gjyqësor meqë edhe i njëjti përmes dëshmisë së tij ka vërtetuar se ditën kritike ka qenë duke zbritur nga automjeti i tij zyrtar mes KEK-ut dhe Gjykatës kur ka parë një person duke ikur e të cilin e ka parë duke i rënë një sasi e arit në tokë dhe ka parë personin i cili është larguar me një shpejtësi të madhe në drejtim të xhamisë. Dëshmitari më tutje ka shtuar se personin e ka parë në një moment shumë të shkurtër dhe se nuk ka mundur ta identifikoj atë megjithëse menjëherë natën kritike i janë ofruar disa fotografi në shikim e po ashtu i janë ofruar edhe disa persona që fizikisht i ka parë por nuk i kanë përngjarë në personin që e ka parë duke ikur.

Dëshmia e këtij dëshmitari është e rëndësishme të vlerësohet nga dy aspekte tejet të rëndësishme dhe atë:

- së pari se është i pakontestueshëm fakti se dëshmitari nuk është përcaktuar natën kur ka ndodhur ngjarja për ndonjë person nga fotografitë e prezantuar dhe as përmes pamjes vizuale të personave tjerë të arrestuar atë natë nga veprimet e operacionit policor “Unaza e hekurt” e kjo është e rëndësishme nga fakti se policia deri në atë kohë nuk kishte në dispozicion fotografi të tani të akuzuarve dhe as që i kishte arrestuar të njëjtit për ti parë dëshmitari;

- dhe së dyti dëshmitari përmes procesverbalit për identifikim ka pohuar se personi me nr.8 i përngjanë personit që ka ikur ditën kritike;

Nga kjo që u tha më lartë nevojitet të qartësohet se vërtetë dëshmitari nuk u përcaktua si kryes të mundshëm në personin tjetër që e pa vizualisht, por, nga fotografia e tij që gjendet në shkresat e lëndës (foto 1 që gjendet në faqe 194 të kallëzimit penal) është një dallim tepër i madh sidomos në elementin qenësor në mjekrën e tij nga fakti se mjekra e tij (bëhet fjalë për personin e ndaluar si të dyshimtë gjatë operacionit “Unaza e çeliktë” të zhvilluar natën kritike- M. R) është shumë më e madhe se e personave tjerë që ka përshkruar dëshmitari dhe se dëshmitari nuk ka pohuar as në procesverbal e as në shqyrtimin gjyqësor se ky person është kryerësi, por i përngjanë atij, për më tepër përkundër kohës së shkurtër të pamjes ka qartësuar edhe dallimet mes personit që ka ikur dhe personit që ka përngjarë në të “...atë ditë duke ikur ka parë vetëm një person dhe ai person ishte i veshur me kapelë të leshtë në kokë dhe ai është me numër 8, dallimi është se flokët i ka pas më të shkurtra dhe ka qenë më i dobët, dhe prapë deklaroi se nuk është i sigurt; se a është ky person apo jo”.¹²

Përkundër këtyre edhe elementet tjera janë të rëndësishme tek ky dëshmitar dhe atë:

- koha e shkurtër e pamjes dhe ikja e shpejtë e personit;

¹² Procesverballi lidhur me identifikimin e personave, dëshmia e dëshmitarit “X”

- koha e muzgut dhe pa ndriçim të duhur;
- frika e dëshmitarit nga fakti se paraprakisht ka dëgjuar një të shtënë;

E që duke pasur parasysh të gjithë faktorët e përmendur, Gjykata vlerëson se ky dëshmitar nuk arriti të jetë bindës se identifikoj kryerësit e kësaj vepre penale.

Dëshmitarët M. J dhe N. H, kanë vërtetuar pohimet që kanë dëgjuar nga dëshmitari S.M dhe atë vetëm një ditë pas ngjarjes së ndodhur duke pohuar se kanë ofruar disa fotografi të personave të ndryshëm dhe se dy nga ta kanë përngjarë në tani të akuzuarit, megjithatë se dëshmitë e tyre janë mjaft të diskutueshme së pari se janë persona zyrtar që kanë përpiluar kallëzimin penal dhe së dyti se dëshmitë e tyre janë dëshmi indirekte përkatësisht dëshmi që mbështesin dëshmitarin S. M, por që padyshim se i diskutueshëm është edhe fakti tjetër se si ishte gjendja shëndetësore e të dëmtuarit një ditë pas rastit të ndodhur dhe përjetimeve të tij gjatë ngjarjes kritike e që duke e ndërlidhur me faktin se gjatë këtij procesi nëse mund të thuhet të identifikimit nuk u përpilua ndonjë raport zyrtar e aq më tepër dëshmitarët nuk arritën që gjatë shqyrtimit gjyqësor të ofrojnë të dhëna se mbi cilën bazë kanë përzgjedhur fotografitë e që duhet të jenë të ngjashme dhe jo të ketë dallime të mëdha, andaj sa u përket këtyre dëshmimeve të dëshmitarëve Gjykata vlerëson se këto dëshmi duhet shikuar dhe trajtuar mbi bazën e dëshmisë së S.M, e cila dëshmi hollësisht është trajtuar në pjesën e mësipërme të këtij aktgjykimi.

Dëshmitari E.I në kafiterin “XX” dhe kanë parë një person duke ikur me revole në dorë ai më parë ka dëgjuar një krismë shumë të dobët e në ndërkohë dy persona duke vrapuar në drejtim të tij dhe shoku të tij Sh.S, e që nga frika kanë ikur në rrugicën në mes “.....” dhe “.....”, e që ka potencuar faktin se këta persona kanë ikur me një shpejtësi mjaft të madhe. Më tutje dëshmitari në rrëfimin e tij ka shtuar faktet se pasi janë kthyer në rrugën kryesore ka parë një polic, i cili kishte qenë gjysmë brenda argjendarisë dhe gjysmë jashtë lokalit, e të cilit i kanë ofruar ndihmë duke e dërguar në spitalin e Ferizajt. Veçanërisht dëshmitari ka potencuar faktin se ngjarja është zhvilluar me shpejtësi shumë të madhe se personat kanë pasur armë, të cilat i kanë pas të drejtuar nga ata dhe për këtë arsye edhe kanë ikur, sa i përket largësisë nga i ka parë ka qenë diku rreth 20-30m, duke përshkruar se kanë pasur kapela në kokë dhe tesha të zeza, por pa arritur që të specifikoj ndonjë karakteristikë të veçantë të fytyrave të tyre, e që përfundimisht ka dëshmuar “...se nuk është në gjendje që ti identifikoj apo njoh këta persona...”,¹³

Po ashtu ngjashëm edhe dëshmitari Sh. S ka përshkruar se ditën kritike ka qenë së bashku me dëshmitarin E. I në afërsinë e kafiterisë “.....” në Ferizaj dhe në momentin kur ka dalë nga automjeti ka dëgjuar dy apo tri të shtëna të revoles dhe që të dy kanë ikur në drejtim të rrugës-sokakut që shpie tek qebaptorja e Hoxhës, e që në ndërkohë ka parë dy persona duke ikur në drejtim të rrugës ka Xhamia e Vogël e që njëri nga ta mbante në dorë një revole-armë. Kurse në pjesë ku i referohet ndihmës së policit të lënduar dëshmitarit S.M, i njëjti ka paraqitur versionin tërësisht të njëjtë me dëshmitarin E. I.

Me rastin e vlerësimit të dëshmimeve të këtyre dëshmitarëve nga fakti se kanë paraqitur versione të njëjta mbi ngjarjen e ndodhur, Gjykata çmon se dëshmitë e tyre janë të sakta dhe objektive përkitazi me të dhënat që kanë prezantuar, por, në të gjitha fazat e procedurës kanë qenë tejet konsistent dhe të palëkundur në deklaratimet e tyre se nuk ka qenë në gjendje të

¹³ Procesverbali i shqyrtimit të pare gjyqësor i dt. 30.05.2007, dëshmia e dëshmitarit E. I.

identifikoj personat të cilët natën kritike kishin kryer veprën penale, duke sqaruar se ka qenë një kohë shumë e shkurtër e zhvillimit të ngjarjes, para muzgut dhe për më tepër edhe vet ishin të frikësuar pasi që personat që iknin në dorë po mbanin revole.

Dëshmitë e dëshmitarëve R. S dhe N. S, nuk paraqesin ndonjë relevancë të veçantë në këtë çështje pos faktit se dëshmitarja ka dëgjuar bisedën mes kryerësve të kësaj vepre penale dhe tani të ndjerit ashtu që derisa ka qenë duke punuar në butikun – lokalin “.....”, i cili ka qenë i ndarë vetëm me një ivericë me argjendarinë “.....”, ka dëgjuar persona ti kenë thënë tani të ndjerit “shtriju, shtriju”, e pas kësaj ka dëgjuar edhe pronarin duke përgjigjur “qe u shtriva”, e që menjëherë pas kësaj ka shkuar në drejtim të një lokali tjetër për ta informuar për ngjarjen, e që po ashtu ka dëgjuar edhe dy krisma të intensitetit të ulët brenda lokalit, si dhe më vonë ka parë policin e përgjakur.

Përkitazi me këtë dëshmitare Gjykata vlerëson se e njëjta ka qenë reale, por pa arritur që të specifikoj detaje lidhur me personat që kishte dëgjuar duke biseduar nuk ka mundur të përcaktoj dialektin e cilit regjion e kanë përdorur këta persona.

Kurse dëshmitari tjetër N. S, në kohën e zhvillimit të ngjarjes ka qenë në xhami duke e falur namazin e akshamit (mbrëmjes) dhe nuk ka parë asgjë rreth ngjarjes së zhvilluar. Andaj edhe dëshmia e tij nuk paraqet kurrfarë relevance në këtë çështje dhe nuk është e nevojshme që të elaborohet më tutje.

Nga dëshmia e dëshmitares M. B, së pari duhet potencuar faktin se e njëjta nuk ka paraqitur ndonjë rrethanë relevante për zhvillimin e ngjarjes, por dëshmia e saj më shumë është përqendruar rreth qëndrimit të të akuzuarve (R. S dhe A. Xh) në banesën e saj dhe të bashkëshortit të saj Z. B, e i cili fakt nuk është kontestuar as nga vetë të akuzuarit. E njëjta në mënyrë të hollësishme ka sqaruar ngjarjen e ditës kritike, sidomos shkuarjen e saj në qebaptore, në rr. “Vëllezërit Gërvalla”, rreth orës 16:30, e që në këtë kohë, A dhe R kishin qenë ende në qebaptore, e të cilët më vonë edhe janë larguar nga aty, për më tepër dëshmitarja, veçanërisht ka sqaruar se të njëjtit rreth orës 17:00 janë larguar nga aty, për tu kthyer në shtëpitë e tyre. Përafërsisht dëshmi të njëjtë ka deponuar edhe dëshmitarja M. H rreth kohës së shkuarjes së të akuzuarve nga kjo qebaptore.

Nga dëshmitë e këtyre dëshmitarëve, vërehet se të njëjtat tentojnë ti ofrojnë një alibi të akuzuarve përkitazi me kohën kur të njëjtit janë larguar nga qebaptorja (ora 17:00), por, dëshmitë tyre janë demantuar në tërësi nga raporti policor për ditën kritike, pasi nga ky raport rezulton se pikërisht në ora 16:55 min. në rr. “e Varoshit” është ndalur automjeti, i tipit “.....” me targa të Kosovës dhe më vonë është liruar pas marrjes së shënimeve, e në të cilin automjet kanë qenë A. Xh.

Nga dëshmia e dëshmitarit S. K,¹⁴ është vërtetuar se i njëjti ka punuar në sallonin e frizer “.....”, e cila gjendet në rrugën prapa gjykatës në Ferizaj, e në afërsi të Xhamisë së Vogël, kurse sa i përket ngjarjes kritike, i njëjti vetëm ka potencuar faktin se ka parë dy persona duke ikur, ka përshkruar rrobat e tyre të zeza dhe se kanë pasur mjekër, për më tepër shikimin e ka bërë nga brendia e sallonit ku punonte, ai përshkruan se ngjarja ka ndodhur në kohën kur ka filluar të errësohet, por çka është esenciale për këtë çështje dëshmitari nuk ka mundur që të përshkruaj karakteristika të personave të kanë ikur, e që edhe përqendrimi i tij

¹⁴ Dëshmia e tij është lexuar nga Procesverbal i seancës së pare kryesore të dt. 26.02.2007, pasi që i njëjti gjendet jashtë vendit.

nuk ka qenë aq i madh nga fakti se ka menduar se ata po shkojnë me vrap për tu falur në xhami.

Ndërsa nga dëshmia e dëshmitarit M. Rr,¹⁵ është vërtetuar se natën kritike ka dëgjuar dy të shtëna të dobëta nga largësia diku rreth 20m, e që menjëherë pas kësaj ka parë dy persona duke ikur në drejtim të xhamisë së vogël, e që njëri nga ta kishte një revole në dorë, i njëjti përveç faktit se ka vërejtur se që të dy kanë pasur kapela në kokë, nuk ka arritur që ti shoh në fytyrë, kurse pjesën tjetër të dëshmisë së tij e orienton rreth ndihmës së ofruar që i ka dhënë.

Duke vlerësuar dëshmitë e këtyre dëshmitarëve, Gjykata të njëjtat i vlerëson të sakta dhe objektive, porse asnjëri nga ta nuk ka arritur të ofroj ndonjë të dhenë relevante përkitazi me shtjellimin e çështjes së trajtuar, pasi që të njëjtit vetëm kanë potencuar se personat kanë pasur kapela në kokë dhe asgjë më tepër, nuk kanë arritur të sqarojnë asnjë nga tiparet që karakterizojnë kryerësit e kësaj veprë penale, e për më tepër nuk kanë treguar pamundësinë e identifikimit të tyre.

Kurse dëshmia e dëshmitarit B. Xh,¹⁶ është e panevojshme të trajtohet nga fakti se i njëjti natën kritike kur ka ndodhur ngjarja, ka qenë i ndaluar nga ana e policisë, si i dyshuar për vrasjen e argjendarit, kurse arrestimi i tij është bërë duke u realizuar operacioni policor “.....”, i njëjti u ndalua në udhëkryqin në dalje të Ferizajt, përkatësisht përballë marketit “.....”, e që i njëjti është liruar natën e njëjtë.

Një dëshmitar padyshim mjaft i rëndësishëm që nuk u dëgjua gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor nga fakti se gjendet në punë të përkohshme në Austri padyshim është dëshmitari M.S,¹⁷ dëshmia e të cilit është e rëndësishme meqë transportoj me automjetin e tij te akuzuarit e tanishëm R.S dhe A. Xh nga udhëkryqi i rrugës së Gjilanit-Varoshit deri në Han te Elezit e qe padyshim se dha një dëshmi tejet interesante së pari gjate hetimeve e pastaj edhe ne shqyrtimin gjyqësor te dt. 11.12.2006, përkatësisht ne shqyrtimin e parë gjyqësor dhe gjithsesi dëshmia e tij përqendrohet ne bisedën telefonike qe ka zhvilluar R. S me një person te panjohur (prokurori i shtetit pretendon se ishte A.K por kjo nuk u zbuluar përkundër përpjekjeve të gjykatës nuk janë siguruar komunikimet) për më tepër ky dëshmitar ka dy versione përkitazi me përmbajtjen e bisedës telefonike, së pari gjate hetimeve ka deklaruar se ka dëgjuar vetëm fjalën “*mall*” që është përdorur gjatë kësaj bisede, e tek gjatë shqyrtimit gjyqësor e plotëson dëshminë e tij se i akuzuari gjatë bisedës telefonike ka thënë se “*do te na arrestojnë*”. Andaj nga këto arsye Gjykata e sheh të nevojshme të trajtoj në mënyrë të posaçme dëshminë e këtij dëshmitari duke analizuar gjithë përmbajtjen e dëshmisë së tij gjatë procedurës hetimore dhe në shqyrtimin gjyqësor.

Së pari dëshmitari ka qenë tejet konsistent në përshkrimin e takimit, përkatësisht edhe gjatë procedurës hetimore e edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka përshkruar se ishte pritur pasagjer me veturën e tij “.....”, kur janë paraqitur këta dy persona e që vetë ka qenë iniciator që udhëtimin për në Han të Elezit ta bëjnë kah rr. ”E Varoshit”, meqë është më e shkurtër, ka potencuar faktin se pikërisht tek pompa e benzines “.....”, janë ndalur nga ana e policisë, e po

¹⁵ Dëshmia e tij është lexuar nga Procesverbal i seancës së pare kryesore të dt. 26.02.2007, pasi që i njëjti gjendet jashtë vendit.

¹⁶ Dëshmia e tij është lexuar nga Procesverbal i seancës së pare kryesore të dt. 30.05.2007, pasi që i njëjti gjendet jashtë vendit.

ashtu edhe janë legjitimuar edhe kontrolluar, nga të cilët edhe janë njoftuar për një vrasje, e që pas kësaj është zhvilluar biseda që është cekur më lartë.

Dëshmia e këtij dëshmitari, është e nevojshme të trajtohet për këto aspekte:

- së pari nga fakti se i njëjti fillimisht është arrestuar nën dyshimin se është kryes i kësaj vepre penale, ndaj tij janë marrë edhe mostrat e parafinës dhe ADN-së;

- së dyti, si është e mundur, që gjatë hetimeve të mos e përmend faktin përkatësisht fjalinë se “do të na arrestojnë” dhe atë vetëm dy muaj pas ngjarjes së ndodhur, kurse ta rikujtoj këtë fjali, në shqyrtimin gjyqësor, i cili është mbajtur pothuajse një vit më vonë (11.12.2006). Për më tepër arsyetimi i tij se nuk e ka shkruar prokurori është në tërësi e pabesueshme dhe e palogjikshme që një pohim kaq të rëndësishëm të mos e shënoj një prokuror;

- e pohimet e lartcekura duke i lidhur me reagimin e A. Xh dhe R. S, të cilët përkundër kontrollit dhe legjitimitetit nga ana e policisë, ishin sjell në mënyrë tepër normale dhe pa dhënë as edhe ndonjë shenjë të frikës apo stresit se po arrestohen;

- megjithatë përkundër këtyre a thua do të ishte e logjikshme që të zhvillohet një bisedë e tillë rreth një vepre kaq të rëndë në prani të një personi të panjohur (taksist) që po i transportonte të akuzuarit.

Nga leximi i raportit të autopsisë i dt. 9.12.2005 janë përshkruar se i ndjeri ka marrë gjashtë plagë të cilat janë përshkruar hollësisht secila nga to dhe të cilat lëndime janë shkaktuar nga arma e zjarrit në kokë dhe abdomen (të shtëna që kanë goditur trurin dhe organet e abdomenit) e të cilat janë edhe shkak i vdekjes.

Gjykata raportit të autopsisë i përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor Dr. M. G, i ka falur besim të plotë me që e njëjta është përpiluar në të arritura shkencore, në mënyrë profesionale, për më tepër janë përshkruar në mënyrë të detajuar plagët e pësuar nga i ndjeri, i cili raport është përcjellë edhe me fotografi gjatë autopsisë dhe duke përshkruar në mënyrë të saktë edhe shkakun e vdekjes.

Përmes leximit dhe shikimit në raportin e krim teknikës 1.12.2005, shikimit në vendin e ngjarjes, shihet se njësitë e krim teknikës menjëherë ka dal në vendin e ngjarjes ku ka bërë ekzaminimet e nevojshme ashtu që punën e tyre e kanë përfunduar në orën 20:20 duke bërë edhe fotografimin e vendit të ngjarjes dhe atë jashtë lokalit dhe në brendësi të lokalit ku shihet një sasi e arit që ka mbetur në tokë, njollat e gjakut si dhe fotografia e tani të ndjerit B. B si dhe disa stoli të arit janë gjetur edhe para lokalit e që të gjitha këto janë shenjëzuar me shenja përkatëse.

Përmes shikimit në foto dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës, është vërtetuar se me dt. 12.05.2006 (e cila datë është shënuar në pjesën e poshtme të djathtë të fotografive), shihet se është bërë renditja e disa personave për identifikim, në mesin e të cilëve janë paraqitur me numër 2 i akuzuari Z. B, me numër 5 i akuzuari R. S dhe me numër 8, i akuzuari A. Xh.

Nga leximi dhe shikimi mendimin dhe konstatimi i e dr. T.G në seancën e dt. 30.9.2007 dhe 8.10.2007, vërtetohet se i ndjeri B. B ka pësuar gjashtë plagë, por nga

fragmentet e tri predhave, kurse sa i përket të dëmtuarit S.M, është konstatuar se ka pësuar lëndime të rënda trupore, të cilat kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit të tij, i njëjti ka pësuar një plagë në zonën e zogut të jashtëm dhe të brendshëm të shputës së djathtë, si dhe lëndime në anën e djathtë të fytyrës, në buzën e sipërme, në zonën e nënmjekrrës, në zonën murore të kokës, të cilat janë shkaktuar nga pjesë të predhës së hudhur nga armë dore e zjarrit.

Kurse nga leximi dhe shikimi në konstatimin dhe mendimi i ekspertit të balistikës prof. H.K të dt. 30.9.2007, vërtetohet se te gjitha gëzhojat e gjetura janë shkrepur nga një arme e kalibrit 7.65 mm, ne te cilën ka qene i vendosur silenciator (shurdhues) i cili përdoret për ndaljen e gazrave dhe predha tejkalon me energji me te vogël dhe shpejtësi më të vogël kurse nuk ka mundur të përcaktohet lloji i revoles së përdorur, sepse me këtë kalibër ka revole të llojeve të ndryshme.

Gjykata i çmoi ekspertizat se janë të përpiluara në mënyrë profesionale, për më tepër nuk gjeti ndonjë rrethanë objektive apo subjektive që do të vinte në dyshim objektivitetin e ekspertëve (mjeko-ligjor dhe balistikës).

Nga leximi dhe shikimi në njoftimin nga Zyra e Interpolit në Shkup i përcjell nga ana e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, vërtetohet se në aspektin teknik nuk ekziston mundësia që të nxirret përmbajtja e bisedave telefonike dhe sms-ve të realizuara nga telefoni mobil 070/808-040;

Kurse nga raporti i detyrës për ndërrimin “D” i dt. 01.12.2005 prej orës 8:00 deri në 24:00, vërtetohet se rasti në polici është raportuar saktësisht në ora 16:15, në të cilin raport janë të përshkruara edhe veprimet policore duke vazhduar me raportin e orës 16:55, për ndaljen e dy personave të dyshimtë nga Maqedonia A. Xh me me veturë “.....” me targa të Kosovës dhe më vonë e liron veturën mbas shënimeve të kolegëve.

Te gjitha këto prova materiale janë prova te besueshme dhe të pakontestueshme por paraqesin vetëm anën objektive te kryerjes se kësaj vepre penale dhe se këto prova nuk ndriçojnë asnjë aspekt subjektiv të kësaj vepre penale e për më tepër nuk paraqesin ndonjë ndërlidhje te drejtpërdrejtë apo te tërthortë se kryerës janë te akuzuarit, andaj nga kjo arsye Gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme që këto prova ti trajtoj më tepër.

Nga leximi dhe shikimi në opinionin e ekspertit për analizën e ADN-së të dt. 22.05.2006, dhënë nga Prof. Dr. M. S, i cili nga mostrat e marra dhe atë tampon me njollë gjaku – B. B, tampon oral M. S, A. Xh dhe R. S, tampon/dorëza e derës, copës pejez dhe duq cigareje dhe nga këto ka rezultuar se analizat e ADN-së të tamponit të dorëzës së derës D.6/2676 dhe duqit të cigares D.5/2676 kanë dhënë profil të plotë (11 loci). Profilat e STRs të nxjerra nga profilat identik mashkullor të personit të panjohur.

Analiza e ADN-së të copëzës së penjezit 7.A/2676 nuk kanë dhënë ndonjë rezultat të dobishëm.

Analizat e ADNs së tamponave orale nga të tre të dyshuarit M. S (6/2676), A. Xh (7/2676) dhe R. S (8/2676) dhe gjithashtu edhe tamponi i viktimës B. B (D1.2/2676) kanë dhënë profila të plotë (11 loci).

Ashtu që këta profila nuk janë gjetur në njollat e përmendura më sipër, te cilët kane dhënë profile te plota dhe të cilat profile te marra janë identike me profile mashkullore te një personi te panjohur, kurse përjashtojnë si burim te gjurmëve për personat M. S, A. Xh dhe R. S.

Nga leximi dhe shikimi në raportin e ekspertizës i prezantuar në raportin e policisë kriminale në Turqi i dt. 29.11.2007 ne te cilën janë ekzaminuar katër pale doreza te përdorura nga ana e mbledhësit te mostrave dhe atë katër mostra te marra nga dora e djathte (brenda dhe jashtë) dhe nga e majta (brenda dhe jashtë) e A. Xh, R. S, M.S dhe M. R, të cilat mostra janë marre me pambuk të zhytur ne acetone e te cilat mostra nuk përmbajnë ndonjë mbetje te elementit të të shtënës (antimon).

Trupi gjykues në mënyrë të veçantë ka vlerësuar analizën e ADN dhe ekspertizën e dorezës se parafinës nga faktet që do ti paraqesim në vijim:

- së pari rëndësia e këtyre provave qëndron se përjashtojnë mundësinë se kryerës janë te akuzuarit;

- këto prova kanë rëndësi të veçantë provuese meqë janë prova shkencore të bazuara në metodat më bashkohore shkencore;

- ekspertizat janë kryer në dy institucione të jashtme (e para në Institutin për Mjekësi Ligjore pranë Universitetit të Insbrukut, kurse e dyta nga Laboratori i Policisë në Ankara);

- dhe se vërtetësia e tyre nuk mund të kontestohet.

5.Vlerësimi i procedurës së identifikimit nga dëshmitarët Blerim Ibishi dhe S.M

Gjykata përkundër vlerësimit të detajuar të dëshmive të dëshmitarëve S.M dhe B. I, megjithatë e sheh të nevojshme që në mënyrë të veçantë të vlerësoj procesin e identifikimit dhe atë nga fakti se identifikimi paraqet aspektin më të rëndësishme në këtë çështje penale bazuar në leximin dhe shikimin e fotografive në procesverbalin mbi identifikimin e personave 12.05.2006, e që fillimisht është vërtetuar se në identifikim kanë marrë pjesë dëshmitari “X” që rezulton të jetë B. I dhe dëshmitari S.M.

Paraprakisht duhet pasur parasysh se procedura e identifikimit është zhvilluar në mënyrë të rregullt konform dispozitave ligjore (neni 255 i KPPK-së), duke aplikuar edhe standardin e kërkuar për identifikim përkatësisht duke paraqitur 10 persona të renditur, mes tyre edhe A. Xh me nr.8, Z. B me nr.2 dhe R. S me nr. 5.

Megjithatë Gjykata pati parasysh se në rastet e identifikimit gjithmonë duhet vlerësuar me një kujdes tepër të veçantë duke vlerësuar vëmendshëm të gjithë faktorët që kanë ndikim në identifikim në rend të parë saktësia e identifikimit, koha e kaluar nga pamja e parë deri te momenti i identifikimit, kohëzgjatja e pamjes, kushtet e pamjes dhe se pamja a është përcjellë me ngjarje traumatike dhe stresi apo jo meqë edhe tek dëshmitarët më të ndershëm, më të sigurt dhe më të saktë gjithmonë ekziston shkallë mjaft e lartë e probalitetit të gabimeve në

identifikim e sidomos nëse ngjarja zhvillohet në rrethana siç kanë ndodhur në këtë çështje penale dhe atë:

- së pari pas përshkrimit që të dy dëshmitarët kanë pohuar se personi i renditur me nr.8 i përngjanë personit që ka kryer veprën penale, kurse asnjëri nga ta nuk ka pohuar me një siguri të lartë se ky person është kryerësi, “...pas shikimit në mënyrë detale në fund ka ardhur në përfundim se personi me numrin 8 i përngjanë personit, i cili ka qenë ditën kritike në argjendarinë “.....””,¹⁸ për të vazhduar më tutje dhe duke paraqitur dallimet në mes personit të identifikuar dhe personit i cili ka qenë në argjendari, “...se personi i cili ka qenë në argjendari ka qenë më i dobët ka pas një mjekër me qime të rralla, ka qenë i moshës 25 vjeçare”¹⁹, e që përfundimisht “... nuk është e sigurve se ky person është qind për qind ai personi, i cili ka shti në të me armë, pasi ka qenë një moment shumë i shkurtër ka qenë me kapelë në kokë dhe nuk ka mundur me vërejtur dhe nuk ka mundur ta identifikoj...”,²⁰ kurse dëshmitari B. I, më herët i njohur si dëshmitari “X”, ka deklaruar “... se personi me numër 8 i përngjan më së shumti këtij personi se personi që ka ikur në drejtim të hekurudhës ka qenë i moshës 25 vjeçare por dhe nuk është i sigurve pasi ka qenë një kohë shumë e shkurtër dhe errësirë dhe ai ka qenë duke ikur, dallimi është se flokët i ka pas më të shkurtra dhe ka qenë më i dobët, dhe prapë deklaroi se nuk është i sigurt, se a është ky person apo jo...”²¹

- identifikimi është bërë diku mbi pesë muaj pas ngjarjes së ndodhur, që është një kohë tejet e gjatë e kaluar nga ngjarja e ndodhur;

- identifikimi ka ndodhur në rrethana tepër specifike përkatësisht dëshmitarët që morën pjesë në identifikim kishin parë personat që kryen veprën vetëm për një kohë tejet të shkurtër dhe atë dëshmitari S.M, për vetëm 2 deri në 3 sekonda, kurse dëshmitari B. I: një kohë shumë të shkurtër përkatësisht rreth 1 minutë, që e bënë shumë të vështirë përkatësisht të pabesueshëm jo të plotë, të mangët dhe të pasigurt identifikimin;

- kryesit e kësaj vepre ishin duke vrapuar, përkatësisht ikur dhe u panë kalimthi “lëvizja e tij ka qenë duke vrapuar”;²²

- me një pamje jo të mirë, në kohën kur po errësohej, “ka qenë një kohë shumë e shkurtër dhe errësirë”²³

- e gërshetuar me një ngjarje traumatike e përcjellë me të shtëna, “prej momentit kur unë kam dëgjuar krismën që kam qenë jashtë automjetit”²⁴

- dhe përfundimisht që të dy dëshmitarët kanë qenë tepër të pasakt me rastin e deklarimit rreth moshës së kryesit të kësaj vepre penale duke përshkruar se i njëjti ishte rreth moshës 25 vjeçare, e që ky detal në shikim të parë edhe pse duket i parëndësishëm, por duhet kushtuar një rëndësi tejet të madhe nga fakti se dy dëshmitarët japin moshën e njëjtë, e që kjo rrethanë duhet ndërlidhur në moshën e të akuzuarit A. Xh, i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ishte mbi moshën 40 vjeçare, e për më tepër nga pamja e fytyrës së tij lenë përshtypjen

¹⁸ Procesverbali lidhur me identifikimin e personave, dëshmia e dëshmitarit/të dëmtuarit S. M

¹⁹ Po aty

²⁰ Po aty

²¹ Po aty

²² Procesverbali i shqyrtimit të fundit kryesor, dëshmia e dëshmitarit B. I, faqe 11.

²³ Procesverbali lidhur me identifikimin e personave, dëshmia e dëshmitarit “X”.

²⁴ Procesverbali i shqyrtimit të fundit kryesor, dëshmia e dëshmitarit B. I, faqe 11.

se mund të jetë person edhe më i vjetër se kjo moshë, atëherë është më se e qartë se dëshmitarët nuk kanë arritur të identifikojnë kryesin e vërtet të kësaj veprë penale.

Nga të dhënat e sipër cekura është shumë e qartë se këta dëshmitarë përveç deklarimit për personin me numër 8, e që është konstatuar se ishte personi A. Xh, kurse sa i përket personave të tjerë R. S dhe Z. B nuk janë përcaktuar që këta persona t'i kenë parë në natën kritike kur ka ndodhur ngjarja.

Andaj mbi bazë të këtyre rrethanave të lartëcekura Gjykata pa asnjë hamendje dhe me bindje të plotë vlerëson se dëshmitarët B. I dhe S.M nuk kanë arritur në mënyrë të sigurt dhe të saktë të identifikojnë A. Xh si person i cili ka qenë i involvuar në veprën penale, kurse sa u përket R. S dhe Z. Q as që janë përcaktuar se janë të involvuar në veprimet në fjalë përkundër faktit se i kishin shikuar në defilimin për identifikim.

6.Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarve

Gjithsesi për te bere një analize te gjitha provave te shqyrtimit gjyqësor është e nevojshme te vlerësohet edhe mbrojtja e te akuzuarve e cila natyrisht asnjëherë nuk duhet te vlerësohet ne mënyrë fragmentare nga provat tjera, te rikujtojmë se te akuzuarit gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor kane zgjedhur për tu mbrojtur ne heshtje dhe se padyshim se Gjykata duhet te vlerëson mbrojtjen e tyre gjate fazave tjera te procedurës penale si dhe nga shqyrtimet e tjera gjyqësore. Kurse natyrshëm në rastet e tilla kur bëhet fjalë për një veprë të kësaj natyre tejet të rëndë është plotësisht e pabesueshme që nga të akuzuarit të arrihet diçka më tepër rreth shtjellimit të kësaj çështje.

Por, nga mbrojtja e tyre shihet se të njëjtit kanë mohuar kryerjen e kësaj veprë penale dhe se mbrojtja e tyre është e përqendruar në sqarimin e ardhjes së tyre në Ferizaj, e që sipas versionit të tyre të mbrojtjes ka qenë një ardhje e zakonshme tek Z. B, me qëllim të vizitës miqësore në banesën e tij.

Edhe pse ardhja dhe qëndrimi i tyre në Ferizaj është tejet misterioze dhe i pa justifikuar në mënyrë bindëse megjithatë këto komponentë (ardhja dhe qëndrimi) absolutisht nuk mund të merren si ardhje për qëllime të kryerje të veprës penale aq më tepër që të akuzuarit kanë dhënë arsyet e tyre në lidhje me ardhjen dhe qëndrimin e tyre e sidomos i akuzuari A. Xh, ka paraqitur arsye tejet të logjikshme përkitazi me kalimin ilegal të kufirit (se nuk ka qenë i pajisur me pasaportë nga autoritet maqedonase), e cila e dhenë është konfirmuar edhe nga shkresa e ministrisë së punëve të brendshme të Maqedonisë.

Nga mbrojtja e të akuzuarve është e nevojshme që të vlerësohet edhe mbrojtja e të akuzuarit Z. B, i cili është akuzuar për veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo grabitjes, e që nga mbrojtja e tij nuk është vërtetuar se ka qenë i implikuar qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në dhënien e ndihmës të të akuzuarve A. Xh dhe R. Sa, për më tepër edhe vet dispozita ligjore që përkufizon ndihmën e për ligjësuar përmes dispozitës së nenit 25 të KPK-së:

“Ndihma për të kryer një veprë penale përfshinë këshillimin ose udhëzimin se si kryhet vepra penale, duke vënë në dispozicion të kryesit mjetet për kryerjen e veprës penale, duke larguar pengesat për kryerjen e veprës penale ose duke i premtuar paraprakisht se do ti fsheh provat e veprës së kryer penale, identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale”.

Andaj nga një përkufizim i tillë për Gjykatën është shumë e qartë se asnjë nga veprimet që kërkohen të përmbushen për ndihmë, nuk janë arritur që të provohen në mënyrë të sigurt se janë ndërmarrë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata vlerëson se kanë mbetur tërësisht të pa mbështetshme dhe në nivel të supozimeve pohimet se i akuzuari Z. B, të ketë ndihmuar të akuzuarit R. S dhe A. Xh në kryerjen e veprave penale, edhe pse nuk është kontestues fakti se të njëjtit qëndruan një natë para ngjarjes në banesën e tij nuk është arritur që të provohet se kanë marrë udhëzime apo kanë planifikuar veprën penale, se ka fshehur gjurmët e veprës penale apo sendet e vjedhura, për më tepër edhe vet aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës në pjesën që i referohet Z. B në mënyrë të qartë hudhë poshtë pretendimet dhe konkludimet e aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë (aktgjykimi P.nr.40/2009 i dt.09.06.2011) “... *sa i takon gjendjes faktike qëndron edhe me të akuzuarin Z. B, ngase “provat” që gjenden në shkresat e lëndës për tani janë të pamjaftueshme për ta mbështetur aktgjykimin dhe shpallë dike fajtor, askush nuk ka deklaruar se në shtëpinë e tij dy të akuzuarit e parë kishin planifikuar grabitjen, asnjë provë apo indicie nuk sugjeron se ai kishte treguar ku gjendet argjendaria apo se u kishte premtuar se do ta fsheh veprën penale apo gjurmët e saj siç ka gjetur gjykata e shkallës së parë- të gjitha këto janë konstatime të prokurorit në aktakuzë (nuk është e qartë se nga i ka nxjerr konkludimet e tilla përfaqësuesi i akuzës) të cilën në tërësi e ka pranuar edhe gjykata e shkallës së parë”²⁵, e në ndërlidhje të kësaj posaçërisht duhet përmendur faktin se vepra e pretenduar se ka kryer ky i akuzuar (Z. B) është derivat i veprës së pretenduar se kanë kryer të akuzuarit (R. S dhe A. Xh), përkatësisht duhet të ekzistoj një lidhje organike mes këtyre veprimeve, andaj edhe mbi këtë bazë edhe është përjashtuar përgjegjësia e tij.*

7. Analiza e fjalës përfundimtare të Prokurorit të Shtetit

Analiza e fjalës përfundimtare të Prokurorit të Shtetit e paraqitur në formën e shkruar ka përshkruar në mënyrë mjaft të gjithanshëm të të gjitha provat e prezantuara.

Prokurori i Shtetit në thelb nuk ka arritur që të paraqes ndonjë provë të themeltë që do të bënte të besueshëm se të akuzuarit janë kryerësit e kësaj vepre penale, por shumica e pretendimeve të tij kanë mbetur në suaza të supozimeve, pa arritur që ta tejkalojnë kufirin e dyshimit të arsyeshëm.

Por ti kthehemi dhe ti analizojmë më hollësisht disa nga këto pretendime:

- së pari “...*duke marrë parasysh mënyrën e kryerjes së veprave, karakteristikat e të akuzuarve të cilët kanë qenë pjesëmarrës të luftës në Maqedoni dhe kanë ditur për gjurmët që do të mbesinë nga përdorimi i armës, të njëjti me bindje të plotë konstatojnë se kanë përdorur mjete mbrojtëse-dorëza apo të ngjashme, siç edhe kanë përdorur mjetin shurdhues të zhurmës në tytën e armës...*”²⁶

Por, Gjykata vlerëson se një pretendim i tillë i Prokurorit të Shtetit, është presupozim i pa mbështetshëm në prova e për më tepër është hipotetike se për çfarë mjeti shurdhues është përdorur kur në fakt nuk është gjetur as arma as shurdhuesi, e nuk janë gjetur as dorëza e as sende të tjera për të cilat pretendohet dhe se në asnjë rrethanë nuk mund te interpretohet ne

²⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme AP. Nr. 444/2011

²⁶ Fjala përfundimtare e Prokurorit të Shtetit

këtë mënyrë, por ne favor të të akuzuarve përkatësisht parimit të mirënjohur juridik **in dubio pro reo**.

Po ashtu pretendimi tjetër – ardhja e të akuzuarve në Ferizaj si dhe mbrojtja në heshtje e tyre, nuk kanë edhe as bazën më të vogël meqë një ardhje e tyre sado që është simptomatike dhe ndoshta edhe e pajustificueshme, por kjo assesi nuk duhet që të trajtohet se të njëjtit kanë ardhur për qëllime kriminale, e aq më tepër edhe mënyra e mbrojtjes në heshtje është e drejtë e garantuar dhe gjithsesi kjo paraqet mënyrën më të mirë se barra e provës bie pikërisht në paditësin.

Më tej Prokurori i Shtetit një pjesë të fjalës së tij përfundimtare e destinon për të përshkruar motivin shtytës që të akuzuarit ta kryejnë këtë vepër penale, përkatësisht situatën e tyre pas konfliktit në Maqedoni, por Gjykata me gjithë respektin nuk mund ti pranoj këto motive nga fakti se vetë shprehja “motiv” nënkupton çdo kush brenda individit që e vë atë në veprim, për më tepër këto paraqesin diçka që më tepër i atribuohet aspektit politik dhe që nuk ka asnjë ndërlidhje me krimin, ndoshta, këto motive do të paraqitnin një bazë për matje të dënimit në rast se të akuzuarit do të gjendeshin fajtor por assesi që kjo të jetë mënyrë për të ardhur deri te një vendim fajësie.

Një argument më tepër për aplikimin e këtij parimi të lartcekur është edhe fakti se këto parime janë aplikuar në shumë raste edhe përmes aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *në rastin Allonet De Ribemont v. Francë, aktgjykimi i datës 10.02.1995, seria A, No.308*, duke theksuar se: “...Në parim gjykatat nacionale mund të informohen mbi të gjitha rrethanat, të cilat janë të ndërlidhura me personalitetin e të pandehurit dhe që mund të ketë ndikim në matjen e dënimit, por jo në vërtetimin e përgjegjësisë së tij penale...”

Po ashtu edhe pretendimi tjetër i prokurorit i shtetit se të akuzuarit kanë gjetur, “... Mënyra më e përshtatshme dhe më e lehtë u gjet grabitja e sendeve të vlefshme me vlerë të madhe dhe të lehta për tu bartur – arit si metali më i çmueshëm”,²⁷ por edhe në këtë pikë Gjykata nuk dakordohet me këtë, nga fakti se vërtet u vodh një sasi e arit, si metal i çmueshëm, por, mbeti misterioz fakti se kush ishin kryesit e kësaj vepre, ashtu siç edhe është shprehur Gjykata Supreme me aktgjykimin e saj: “... Kontestuese janë faktet se këtë krim e kryen të akuzuarit siç ka gjetur gjykata e shkallës së parë apo ata nuk janë fare të involvuar në këtë krim siç pretendojnë të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre...”.²⁸ Për më tepër misterioz ka mbetur edhe ari, i cili as sot e kësaj dite nuk është gjetur, përkundër kontrollimit në banesat e të akuzuarve dhe kontrollimit në veturën e ndalur nga policia ku ishin të akuzuarit.

Dhe së fundi ajo që Gjykata vërtetë dakordohet me pretendimet e Prokurorit të Shtetit, është pjesa përfundimtare e fjalës së tij dhe këtu vërtetë është e qartë se padyshim bëhet fjalë për një krim tejet të rëndë se është e pakontestueshme se bashkëshortja e të ndjerit ka mbetur e vejë dhe fëmijët pa prindin e tyre dhe vërtetë kjo është për keqardhje, por, çështja që është shqyrtuar ka pasur që të vërtetohet se a ishin vërtetë këta kryesit e kësaj vepre apo jo, e cila dilemë është kërkuar edhe nga kjo Gjykatë sidomos pas udhëzimeve nga Gjykata Supreme e Kosovës përmes vendimeve të saj “nëse edhe përkundër vlerësimit të kujdesshëm të provave një nga një dhe në lidhmëri me njëra-tjetrën edhe më tej nuk janë evituar dilemat, Gjykata vendos me aktgjykim në mënyrën, e cila është e favorshme për të pandehurin”.²⁹

²⁷ Fjala përfundimtare e Prokurorit të Shtetit

²⁸ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme AP. Nr. 444/2011

²⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme AP. Nr. 444/2011

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “*in peius*” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “*in favorem*” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarve dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohej si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ, për më tepër këto parime janë aplikuar në shumë raste edhe përmes aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke u shprehur se:

“...prezumimi i pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që kryerja e detyrave nga anëtarët e një gjykate nuk duhet të fillojë me idenë e paracaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet, se barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit...” **(shih vendimet e GJEDNJ Minelli kundër Zvicrës; John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 shkurt 1996; Telfner kundër Austrisë 20 qershor 2001).**

“...që kryerja e detyrave nga anëtarët e një gjykate nuk duhet të fillojë me idenë e paracaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet, se barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit. Parimi i prezumimit të pafajësisë mund të shkelet edhe në mungesë të një deklarimi formal; mjafton të ekzistojë një arsyetim, i cili të sugjerojë se gjykata e konsideron të akuzuarin si fajtor, si edhe kur barra e provës kalon nga prokurori te mbrojtja...” **(Shih vendimet e GJEDNJ John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 shkurt 1996; Telfner kundër Austrisë 20 qershor 2001).**

8.Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

Konform nenit 112 par.3 të KPPK-së, Gjykata ka udhëzuar përfaqësuesin e të ndjerit B. B bashkëshorten e tij N. B si dhe të dëmtuarin S.M, që realizimin e kërkesës pasurore – juridike mund ta realizojnë në kontest civil.

Konform nenit 103 par.1 të KPPK-ës, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve të kësaj Gjykate.

Andaj Gjykata bazuar në provat e prezantuara ka konstatuar se nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale në fjalë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË
RËNDA, me PKR.nr.1/2013 - P94/12 PR1**

**Sekretarja juridike,
Albana Ajvazi**

**Kryetari i trupit gjykues,
Agim MALIQI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.